



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.96

8 shtator

2006

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Dekret nr.5025 datë 25.8.2006	Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare.....	3967
Vendim i KM nr.583, datë 23.8.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për ceremonialin zyrtar të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar.....	3967
Vendim i KM nr.587, datë 16.8.2006	Për ndryshimin dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor....	3969
Vendim i KM nr.590, datë 31.8.2006	Për zbatimin e ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”	3974
Vendim i KM nr.593, datë 31.8.2006	Për transferimin e Teatrit Kombëtar dhe të Galerisë Kombëtare të Arteve në mjediset e Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës “Pjetër Arbënor”.....	3975
Vendim i KM nr.595, datë 31.8.2006	Për miratimin e tarifave të shërbimit “Posta direkte”.....	3976
	Për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarëve z.Mude Bakalli, Nezir Muça, Ramiz Muça.....	3976
	Ndreqje gabimi.....	3978

DEKRET
Nr.5025, datë 25.8.2006

PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” të Kushtetutës, të neneve 15,19 dhe 20 të ligjit nr.8389, datë 5.8.1998 “Për shtetësinë shqiptare”, bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Brendshëm,

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

- | | |
|-------------------------------------|------------------------------------|
| 1.Nefisejda Fatmir Deliu | 13.Drita Banush Hartmaier (Zylyfi) |
| 2.Ardit Dyl Tula | 14.Ermira Idriz Michas (Godelli) |
| 3.Albana Azem Dervishi | 15.Ergys Abdyl Jahja |
| 4.Semy Abdula Selimi | 16.Arian Miltiadh Devole |
| 5.Taze Zenel Born (Çuka) | 17.Alfred Astrit Cani |
| 6.Juliana Filljon Heid (Myteberi) | 18.Kendjola Rahim Çepele |
| 7.Arben Hasan Schneider (Bardhoshi) | 19.Xhino Bebi Shameti |
| 8.Alba Qamil Litges (Lamko) | 20.Orjeta Stavri Aliu (Ndreçka) |
| 9.Klarita Gani Osmani | 21.Abaz Sulejman Hoxha |
| 10.Paris Rushan Topçiu | 22.Isuf Haqif Osmani |
| 11.Irena Fehim Topçiu (Kaja) | 23.Tonet Syrja Lorenzen |
| 12.Borana Paris Topçiu | 24.Marinaqi Petro Rebernik (Basha) |

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Alfred Moisiu

VENDIM
Nr.583, datë 23.8.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.229, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR CEREMONIALIN ZYRTAR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12, pika 2, e 49 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në aneksin e ceremonialit zyrtar të Republikës së Shqipërisë, të miratuar me vendimin nr.229, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Titulli i pikës 5 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“5. Pajisja me targa CD dhe TR (jeshile)

2. Në pikën 5, nën pikat 5.1, 5.2, 5.4, 5.5, 5.7, 5.8, 5.9, 5.14, 5.16, 5.18 dhe 5.19 ndryshohen si më poshtë vijon:

“5.1. Numri i automjeteve, të importuara apo të blera në vend, nga misionet diplomatike, organizatat ndërkombëtare, të nevojshme për përdorim zyrtar, duhet të jetë i arsyeshëm dhe në varësi të madhësisë dhe të nevojave të misionit, por, në çdo rast, numri i tyre nuk mund të kalojë numrin e stafit diplomatik të këtij misioni. Automjetet pajisen me targë CD ose TR (jeshile). Ky rregull zbatohet edhe për automjetet, e importuara apo të blera në vend, nga agjencitë e specializuara të OKB-së, të cilat pajisen me targë CD.

5.2 Shefat e misionëve diplomatike dhe të organizatave ndërkombëtare, që me marrëveshje dypalëshe janë të barazuara me misionet diplomatike, mund të importojnë në emër të tyre, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, dy automjete për përdorim personal, njëra prej të cilave jepet për bashkëshortin/en, të cilat pajisen me targë CD.

...
5.4 Shefat e agjencive të specializuara të OKB-së, në Shqipëri mund të importojnë, në emër të tyre, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, një automjet për përdorim personal, i cili pajiset me targë CD. Mund të importohet ose të blihet në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, edhe një automjet tjetër shtesë, nëse personat në fjalë janë të shoqëruar nga bashkëshortja/i.

5.5 Anëtarët e përfaqësive diplomatike, të organizatave ndërkombëtare dhe të agjencive të specializuara të OKB-së, mbajtës të pasaportave diplomatike, mund të importojnë ose të blejnë në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, një automjet, ekskluzivisht për t'u përdorur prej tyre. Mund të importohet ose të blihet në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, edhe një automjet tjetër shtesë, nëse anëtari është i shoqëruar nga bashkëshorti/ja. Automjetet pajisen me targë CD.

...
5.7 Kërkesa për pajisjen me targë CD ose TR (jeshile) të automjeteve personale bëhet vetëm pas pajisjes, nga protokollin i shtetit, me kartë identiteti të anëtarit të përfaqësive diplomatike, të organizatës ndërkombëtare dhe agjencive të specializuara të OKB-së dhe të bashkëshortit/es.

5.8 Konsujt e nderit, pavarësisht nga shtetësia, ekskluzivisht për qëllime zyrtare, përdorin një automjet, i cili pajiset me targë të zakonshme kombëtare dhe me një shenjë dalluese, ovale, në të djathtë të targave kombëtare, me simbolet HCC. Ky automjet mund të importohet apo blihet në Shqipëri, pa doganë.

5.9 Anëtarët e përfaqësive diplomatike, mbajtës të pasaportave diplomatike, mund të importojnë ose të blejnë në vend, pa taksa doganore dhe taksa të tjera, ekskluzivisht për përdorim personal, një motoçikletë. Për pajisjen e motoçikletave personale me targë CD ndiqet e njëjta procedurë si për automjetet.

...
5.14 Për pajisjen e automjeteve me targë CD, TR (jeshile) dhe HCC dhe me lejeqarkullimi, përfaqësitë diplomatike, organizatat ndërkombëtare, agjencitë e specializuara të OKB-së dhe konsullatat e nderit, duhet të paraqesin kërkesën, me notë verbale, në protokollin e shtetit, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku duhet të shënojnë qëllimin, për të cilin do të përdoret automjeti, emrin e pronarit, tipin e automjetit, numrin e shasisë, ngjyrën, si dhe një fotokopje të vërtetimit-zhdoganimit, të faturës së zhdoganimit, të vërtetimit të hyrjes së automjetit, të lëshuar nga dogana ku është zhdoganuar, dokumentin e hyrjes, të lëshuar nga pika e kalimit kufitar, dhe fotokopjen e kartës së identitetit, në rastin kur automjeti është për përdorim personal. Nota duhet të dërgohet në protokollin e shtetit. Pas kësaj, përfaqësia diplomatike, organizatat ndërkombëtare ose konsujt e nderit dorëzojnë notën në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor, e cila i pajis këto automjete me leje qarkullimi dhe me targë CD, TR (jeshile) apo HCC.

...
5.16 Targat CD, TR (jeshile) dhe HCC nuk janë të transferueshme, kur automjeti, që i mban ato, shitet ose ndryshon pronësi, në çfarëdo mënyre.

...
5.18 Numri i targave do të jetë në mënyrë progresive, me përjashtim të ambasadorit ose të përfaqësuesit të organizatës, i cili do të mbajë në automjetin e vet, zyrtar dhe personal, nr.001.

5.19 Përfaqësitë diplomatike, konsullatat e nderit, organizatat ndërkombëtare dhe agjencitë e

specializuara të OKB-së, pas pajisjes së automjetit me targë CD, TR (jeshile), ose TR e zakonshme (në rastin e konsujve të nderit) duhet të njoftojnë protokollin e shtetit, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, për numrin e targës së dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor. Gjithashtu, kjo e fundit, duhet të njoftojë protokollin e shtetit për targat e dhëna.”.

3. Pika 5.22, e numërtuar gabim në vendimin bazë, bëhet 5.21.

4. Pika 5.23 dhe 5.24 bëhen, përkatësisht 5.22 dhe 5.23.

5. Pika 5.25 bëhet 5.24 dhe riformulohet, si më poshtë vijon:

“5.24. Sipas rregullave ekzistuese, misionet, kur anëtarët e personelit, të çdo kategorie, pronarë të automjeteve pa doganë, që largohen përfundimisht nga Shqipëria, në mbarim të misionit zyrtar, në rastet kur marrin me vete automjetet, duhet të kthejnë, me notë verbale targën CD, TR (jeshile), si dhe lejet e qarkullimit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor. Konsujt e nderit duhet të kthejnë shenjën dalluese HCC pranë protokollit të shtetit dhe, pas kësaj, të bëjnë njoftimin në protokollin e shtetit. Nota verbale duhet të shoqërohet me fotokopjen e dokumentit të çregjistrimit, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.587, datë 16.8.2006

PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA
MJEDISEVE NGA MINISTRIA E EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
INSTITUTIT TË SIGURIMEVE TË KUJDESIT SHËNDETËSOR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, 15 e 16 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të Qendrës së Gjeologjisë Civile, Tiranë, të përbëra nga ndërtesa 4-katëshe, me sipërfaqe të përgjithshme 1893,5 m³ dhe sipërfaqe të lirë oborri 988,2 m² nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe kalimin e tyre Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, sipas planimetrisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Nga sipërfaqje e përgjithshme 1893,5 m², pjesa me sipërfaqe 322,58 m², që është laborator i Qendrës së Gjeologjisë Civile, Tiranë, sipas planimetrisë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për arsye teknike, t’i mbetet në përdorim kësaj qendre deri në sistemimin e saj me mjedise të tjera, të përshtatshme.


3. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të ish-Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, Tiranë, të përbëra nga kati i parë i një ndërtese, me sipërfaqe të përgjithshme 303 m², sipas planimetrisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhen këtij vendimi, nga Instituti i Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor te Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

4. Ngarkohen Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Drejtori i Përgjithshëm i Institutit të Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor dhe kryeregjistruesi i Zyrave Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Shkalla 1:500



Ndertesa : Sip. Totale 1893.5 m²
Qendra e Gjeologjise Civile(kati 1+2+;
ISKSH (kati 4)


Pharm. Clin. Toxicol. 1999; 2: 100-103

QENDRA E GJELOGJISE CIVILE.


Krugg: Sam. Fröscher Nr 31

LABORATORIUM (Laboratori i Analizave
te vetive fiziko-mekanike)
te Shkencimit e Diferave

TIRANE.



Sipärtägia pry 322,58 m² qe do t:
naelet ne funksion të laboratorit të



SHKALLA 1"=100

VENDIM
Nr.590, datë 31.8.2006

**PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR.9588, DATË 25.7.2006 “PËR RILLOGARITJEN
E PENSIONEVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7 të ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve” dhe të nenit 8 të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Rillogaritjen e pensioneve të caktuara nga data 1.1.1994 deri më 31.12.1996.

1. Në zbatim të nenit 2 të ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”, pensioneve, që kanë datë fillimi nga data 1.1.1994 deri më 31.12.1996, përfshirë edhe këtë datë, u indeksohet paga mbi të cilën është llogaritur baza e vlerësuar dhe paga neto, për periudhën nga data 1.1.1994 deri në datën e fillimit të pensionit individual por, në çdo rast, brenda periudhës 1.1.1994 deri më 31.12.1996.

2. Indeksi bëhet sipas procedurave dhe koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësuar të vitit përkatës. Koeficientët e indeksimit të bazës së vlerësuar individuale, pas vitit 1994, sipas viteve, përcaktohen në vendimin nr.400, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual për llogaritjen fillestare të pensioneve”.

3. Rillogaritja e masës së pensionit dhe indeksimet bëhen në bazë të pagave të dokumentuara e të paraqitura në dosjen individuale të pensionit dhe mbi të cilat është caktuar masa e pensionit fillestar.

II. Rillogaritjen e pensioneve të caktuara nga data 1.1.1997 deri më 14.6.2005.

1. Në zbatim të nenit 3 të ligjit nr.9588, datë 25.7.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”, pensioneve, që kanë datë fillimi nga data 1.1.1997 deri më 14.6.2005, përfshirë edhe këtë datë, u rillogaritet baza e vlerësuar, sipas nenit 59, dhe u indeksohet paga neto, sipas nenit 32 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Për periudhën e sigurimit para datës 1.1.1994, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar, përdoren pagat referuese, të përcaktuara në vendimin nr.561, datë 12.8.2005 të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pagës referuese për llogaritjen e pensioneve”.

3. Nga data 1.1.1994 dhe deri më datën e fillimit të pensionit këto paga do të indeksohen me koeficientin e indeksimit të vitit përkatës, të përcaktuara në vendimin nr.400, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”.

4. Për periudhën e sigurimit nga data 1.1.1994 dhe deri në datën e fillimit të pensionit, për efekt të llogaritjes së bazës së vlerësuar, merren pagat mbi të cilat janë paguar kontributet, të indeksuara me koeficientin e indeksimit të vitit përkatës, sipas përcaktimeve të vendimit nr.400, datë 21.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e koeficientëve të indeksimit të bazës së vlerësimit vjetor individual, për llogaritjen fillestare të pensioneve”.

5. Paga neto e tri viteve rresht, në dhjetë vitet e fundit të punës, rillogaritet duke përdorur të njëjtët koeficientë indeksimi, si edhe për rillogaritjen e bazës së vlerësuar.

6. Periudhat e sigurimit pas datës 1.10.1993, të njohura të vlefshme për efekt llogaritjeje pensioni, por të pashoqëruara në kohën e caktimit të pensionit me dokumentin që vërteton pagën për çdo muaj, duke u bazuar në nenin 60 të ligjit nr.7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në nivel minimal.

III. Masa e re e pensionit, e rillogaritur sipas krerëve I dhe II, të këtij vendimi, rritet radhazi, sipas përqindjeve të rritjes së pensioneve të përcaktuara në vendimet e Këshillit të Ministrave, për rritjen e pensioneve, por, në çdo rast, për periudhat nga data e caktimit të pensionit individual e deri në datën 1.7.2006, përfshirë edhe rritjen e caktuar me vendimin nr.399, datë 21.6.2003 të Këshillit të Ministrave “Për rritjen e pensioneve”.

Masa e pensionit, që rezulton pas rillogaritjeve dhe zbatimit të rritjeve, është masa përfundimtare e pensionit individual. Kur kjo masë pensioni rezulton më e vogël se pensioni ekzistues,

atëherë nuk ndryshon, duke u vlerësuar si e drejtë e fituar.

IV. Efektet financiare, për vitin 2006, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, llogariten në shumën 465 000 000 (katërqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekë, nga të cilat 30 000 000 (tridhjetë milionë) lekë shpenzime administrative, dhe përballohen nga fondi i kontigjencës së Këshillit të Ministrave dhe nga fondet shtesë, të përcaktuara në ligjin nr.9601, datë 28.7.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2006””.

V. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore të nxjerrin udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.7.2006.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.593, datë 31.8.2006

PËR TRANSFERIMIN E TEATRIT KOMBËTAR DHE TË GALERISË KOMBËTARE TË ARTEVE NË MJEDISËT E QENDRËS NDËRKOMBËTARE TË KULTURËS “PJETËR ARBNORI”

Në mbështetje të nenit të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 10 e 15, shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme, të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin e Teatrit Kombëtar dhe të Galerisë Kombëtare të Arteve në Qendrën Ndërkombëtare të Kulturës “Pjetër Arbënorin”.

2. Brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të bëjë lirimimin e mjediseve dhe sipërfaqeve funksionale të Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës nga aktivitetet private e të përgatisë rikonstrukcionin e qendrës në funksion të destinacionit të ri publik.

3. Ngarkohet Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.595, datë 31.8.2006

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT “POSTA DIREKTE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 9 e 6, pika 3 të ligjit nr.8530, datë 23.9.1999 “Për shërbimin postar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e

VENDOSI:

1.Miratimin e tarifave të shërbimit “Posta direkte”, për kufijtë e zonës së rezervuar, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2.Ngarkohet Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

TARIFAT E POSTËS DIREKTE

Tabela nr.1

Pesha gr	Tarifat bazë në lekë	1-1000 cp.	1001-10000	10001-50 000	50001-100000	100001-200000	200001-500000
0-20	40	40	30	28	26	24	22
21-50	50	50	32	30	28	26	24
51-100	55	55	35	33	31	29	27

SHPLLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM

Ministria e Brendshme, shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarëve z.Mude Bakalli, Nezir Muça, Ramiz Muça.

Subjekti kërkues është Bashkia Tiranë. Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vemë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni ka të bëjë me sipërfaqen që shpronësohet prej 4973 m².

**TE DHENAT MBI LISTEN EMERORE TE PERSONAVE DHE PRONAVE
QE DO TE SHPRONESOHEN PER ZGJERIMIN E VARREZAVE TE ZHARRRES- FAZA II.**

	Nr.	Emer Mbiemer	Siperfaqia ne m2	Çmimi ne leke/m2	Vlera ne leke	Lloji i dokumentit
I	1	Qamile Hoxha (Muça)	516.25	3000	1548750	Çertifikate nga ZRPP
	2	Sanije Kodra (Muça)	516.25	3000	1548750	Çertifikate nga ZRPP
	3	Shefqet Shima (Muça)	516.25	3000	1548750	Çertifikate nga ZRPP
	4	Mude Bakalli	516.25	3000	1548750	Çertifikate nga ZRPP
		Perfaqesuese Mude Bakalli per GR.I	2065		6195000	
II	1	Ike Lamuç	117.857	3000	353571	Çertifikate nga ZRPP
	2	Sofie Lamuç	117.857	3000	353571	Çertifikate nga ZRPP
	3	Xhelal Muça	117.857	3000	353571	Çertifikate nga ZRPP
	4	Sanie Hyka	117.857	3000	353571	Çertifikate nga ZRPP
	5	Ramiz Muça	117.857	3000	353571	Çertifikate nga ZRPP
	6	Asllan Muça	117.857	3000	353571	Çertifikate nga ZRPP
	7	Qanie Muça	16.837	3000	50511	Çertifikate nga ZRPP
	8	Bedri Muça	16.837	3000	50511	Çertifikate nga ZRPP
	9	Mnexhmije Karaj	16.837	3000	50511	Çertifikate nga ZRPP
	10	Suzana Xhepa	16.837	3000	50511	Çertifikate nga ZRPP
	11	Bujar Muça	16.837	3000	50511	Çertifikate nga ZRPP
	12	Agron Muça	16.837	3000	50511	Çertifikate nga ZRPP
	13	Arben Muça	16.837	3000	50511	Çertifikate nga ZRPP
		Perfaqesues Ramiz Muça per Gr.II	825		2475000	
III	1	Vane Muça	77.148	3000	231444	Çertifikate nga ZRPP
	2	Rakibe Shkrepa	77.148	3000	231444	Çertifikate nga ZRPP
	3	Nezir Muça	77.148	3000	231444	Çertifikate nga ZRPP
	4	Qefsere Zeneli	77.148	3000	231444	Çertifikate nga ZRPP
	5	Sherife Brari	77.148	3000	231444	Çertifikate nga ZRPP
	6	Qamil Muça	77.148	3000	231444	Çertifikate nga ZRPP
	7	Bajram Muça	77.148	3000	231444	Çertifikate nga ZRPP
	8	Mynevere Meqemeja	77.148	3000	231444	Çertifikate nga ZRPP
	9	Maliq Muça	77.148	3000	231444	Çertifikate nga ZRPP
	10	Abdulla Zeneli	347.167	3000	1041501	Çertifikate nga ZRPP
	11	Ervin Zeneli	347.167	3000	1041501	Çertifikate nga ZRPP
	12	Shaban Muça	694.333	3000	2082999	Çertifikate nga ZRPP
		Perfaqesues Nezir Muça per Gr.III	2083	3000	6249000	
LISTA E PERFAQESUESVE TE TRE GRUPEVE BASHKEPRONAREVE						
	1	Mude Bakalli	2065	3000	6195000	Çertifikate
	2	Ramiz Muça	825	3000	2475000	Çertifikate
	3	Nezir Muça	2083	3000	6249000	Çertifikate
NE TOTAL			4973	3000	14919000	

NDREQJE GABIMI

Në Fletoren Zyrtare nr.78 në ligjin nr.9572, datë 3.7.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, neni 21, në faqen 2260, fjalia në fund të rreshtit plotësohet:

... nënligjore që rregullojnë këtë fushë.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark", prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 042 555 63; ose 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 18 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

- 1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
- 2. KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
- 3. REGJISTRAT E NOTERISË**
- 4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI**

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK	1500
(2006).....	
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005)	600
.....	
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të-2006)	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET...(+ suplement 2006).....	1500
5. PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500

Botime të reja

1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I).....	1000
2. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006(VëllimiII).....	500
3. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi I).....	1000
4. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II).....	500
5. PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDERKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË.....	1000
6. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PUSHTETI VENDOR.....	800
7. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PER NDERTIMET.....	500
8. PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006).....	1000
9. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQERITË TREGTARE.....	500

Hyri në shtyp më 6.9.2006
Doli nga shtypi më 8.9.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Ilar"
Tiranë, 2006

Çmimi 150 lekë